



**VENDIM**

***Nr.6, Datë 27.01.2016***

**MBI  
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË  
MENAXHIMIT TË KAPACITETIT NDËRKUFITAR**

Në mbështetje të neneve 16; 67 dhe 110 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punes për fillimin e proçedurave për miratimin e rregullave të menaxhimit të kapacitetit ndërkufitar dhe draftin përkatës,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria OST sh.a me shkresën nr. 5171/5 Prot., datë 15.12.2015 ka depozituar në ERE për miratim konform nenit 65 pika 1 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“, “Rregulloren e menaxhimit të kapacitetit ndërkufitar.“

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores të menaxhimit të kapacitetit ndërkufitar
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

